



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:111078
Datë: 26.09.2024
Numri i dokumentit: 06217243

Ac.nr.7185/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Besnik Bislimaj dhe Rafet Haxhaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit D.K., nga fshati M., Komuna e Suharekës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.M., avokat në Prishtinë, rr. "...", kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës - Zyra Ligjore e Policisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit pagesa e pagës jubilarë dhe diferencës për tre pagat përcjellëse, duke vendosur sipas ankesës të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, C.nr.400/2020, të datës 10.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 26.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës - Zyra Ligjore e Policisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, C.nr.400/2020, i datës 10.10.2022, dhe çështja gjykohet si vijon: **REFUZOHET** e pabazuar kërkesëpadia e paditësit D.K., nga fshati M., Komuna e Suharekës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës - Zyra Ligjore e Policisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të shumë s të mbetur për tre paga përcjellëse t'ia paguaj shumën prej 336.30 €, si dhe në emër të shpërblimeve jubilarë shumën prej 1,819.08 €, në shumën e përgjithshme prej 2,155.38 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.400/2020, të datës 10.10.2022, ka vendosur si vijon: "I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit D.K. nga fshati M., Komuna e Suharekës, ashtu që DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës – Zyra Ligjore e Policisë së Kosovës në Prishtinë që t'ia paguaj

paditësit pagën jubilarë për 39 vite përvojë të punës në vlerë të tri pagave mujore të tij dhe atë në shumë prej 1.819.08 € (një mijë e tetëqind e nëntëmbëdhjetë euro e tetë cent) si dhe në emër të tre pagave përcjellëse obligohet e paditura të ja paguaj shumën prej 336.30 € (treqind e tridhjetë e gjashtë euro e tridhjetë cent), me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë më 08.09.2020, e deri në përmbushjen përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm, ku pjesa tjetër e pagave përcjellëse refuzohet si e pabazuar; II. OBLIGOHET e paditura që palës paditëse t'ia paguaj shpenzimet e procedurës 104 € për përpilimin e padisë dhe për taksën gjyqësore shumë prej 30 euro, të gjitha këto obligohet i padituri që ti paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm”.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovoi ankesën e të paditurës si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar C.nr.400/2020, të datës 10.10.2022 ta prish si kundërligjshëm ose ta refuzojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësi përmes të autorizuarit të tij, me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pa bazuar dhe aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 pika e) e lidhur me nenin 201 par.1 pika d) të Ligjit nr.3/L-006 për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton së paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, më datë 09.09.2020, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për pagesën e tre pagave për shpërbllim jubilar dhe pagesën e diferencës për tre pagat mujore përcjellëse, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi kërkesëpadi, ashtu që të detyrohet e paditura të ia paguaj shumat e specifikuar si në petitum të padisë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave e shkresa të lëndës, bazuar në nenit 150 par.1 të LPK-së, ka nxjerrë aktgjykim për shkak të padëgjushmërisë C.nr.400/2020, të datës 10.10.2022, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata ka theksuar se e paditura aktvendimin për përgjigje në padi, padinë dhe provat i ka pranuar për herë të parë me datën 17.09.2021, mirëpo meqë nuk ka ushtruar përgjigje në padi brenda afatit ligjor, gjykata për herë të dytë ia ka dërguar këto shkresa në adresën e Ministrisë së Drejtësisë – Avokaturës Shtetërore, të cilat janë pranuar me datën 02.11.2021 dhe pasi që përsëri e paditura nuk ka ushtruar përgjigje në padi brenda afatit ligjore, gjykata konform nenit 150 të LPK-së ka arritur në përfundimin se janë përmbushur kushtet për sjelljen e aktgjykimi për shkak të pa dëgjueshmërisë. Tutje, gjykata në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar ka listuar provat të cilat i ka marrë për bazë me rastin e vlerësimit të themelësisë së kërkesëpadisë së paditësit dhe duke iu referuar nenit 52 dhe 53 të Marrëveshjes

së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, si dhe nenit 90 të Ligjit të Punës, ka vendosur që kërkesëpadinë e paditësit të aprovoj pjesërisht si të bazuar duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Vendimin për kamatën e ka bazuar në nenin 378 dhe 382 të LMD-së, ndërsa vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore e ka marrë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 452 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit duke shqyrtuar ankesën e të paditurës brenda kufijve të saj, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m), si dhe për zbatimin e së drejtës materiale ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i shqyrton gjykata sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera që pretendohet me ankesë, gjendja faktike është konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, por gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit për pagesën e tri pagave jubilarë dhe pagesën e diferencës për tri paga përcjellëse dhe prandaj u desh që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe të gjykohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (e) të LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Gjykata e Apelit, fillimisht vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje juridike kontestimore. Kjo pasi që nga lista e pagave e nxjerrë nga Buxhet i Republikës së Kosovës, e datës 01.02.2020, e cila gjendet në shkresat e lëndës, është vërtetuar se paditësi deri me këtë datë ka pasur 39 vite përvojë pune, ndërsa nga vendimi i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, i datës 20.01.2020, vërtetohet se i padituri është pensionuar me datën 20.01.2020.

Ndonëse gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejtë dhe plotësisht gjendjen faktike, e njëjta sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit ka bërë zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Kjo sepse me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, të lidhur dhe nënshkruar nga Organizatat e Punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të Punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës) dhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Dispozita nga neni 82 i kësaj Marrëveshje parasheh që: *“Kjo Marrëveshje e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e nënshkruar nga Partnerët në Këshillin Ekonomiko – Social të Kosovës, hyn në fuqi nga data 01.01.2015”*. Në anën tjetër, dispozita e nenit 90 par.4 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, parasheh që *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”*. Nga kjo rezulton se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, ka qenë në fuqi nga data 01.01.2015, deri me datë 31.12.2017, dhe kjo referuar edhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme GJ.A.nr.40/2023, të datës 27.02.2023, lidhur me vlefshmërinë e Marrëveshjes së Përgjithshme dhe Kontratave Kolektive. Andaj neni 52 i MPKK-së me të cilin parashihet se: *“I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1. për 10 vjet të përvojës*

në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një paga mujore të tij; 1.2. për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3 .për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. 2. Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. 3. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”, si dhe neni 53 i po të njëjtës me të cilin parashihet se: “I punësuari, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt te fundi”, aplikohen vetëm nëse i punësuari e plotëson kushtin e arritjes së viteve jubilarë të përvojës së punë dhe arrin moshën e pensionimit gjatë periudhës sa ka qenë në fuqi kjo marrëveshje.

Në rastin konkret është vërtetuar se paditësi deri me datë 01.02.2020, kur është nxjerrë lista e pagave nga Buxheti i Republikës së Kosovës, ka arritur 39 vite përvojë pune, përkatësisht vitin jubilar prej 30 vite përvojë punë tek e paditura e ka arritur në vitin 2011, pra para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, në të cilën paditësi e bazon kërkesën. Andaj, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar pasi që paditësi nuk ka pasur vit jubilar 10, 20 apo 30 vite, ashtu siç përcaktohet me nenin 52 të MPKK, gjatë periudhës sa e njëjta ka qenë në fuqi, Andaj, duke qenë së i njëjti vitin jubilar prej 30 viteve e ka arritur në vitin 2011 dhe me asnjë dispozitë të kësaj kontrate nuk është paraparë efekti prapaveprues i saj, do të thotë se e njëjta nuk gjen zbatim për rastet kur të punësuarit vitet jubilarë prej 10, 20, 30 viteve i kanë plotësuar para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Kolektive, siç është rasti i paditësit. Po ashtu, sa i përket kërkesës së paditësit për pagesën e pagave përcjellëse pas pensionimit, duke qenë se është vërtetuar që paditësi sipas vendimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, është pensionuar me datën 20.01.2020, as neni 53 i MPKK nuk gjen zbatim pasi që paditësi është pensionuar pas skadimit të vlefshmërisë së MPKK. Dispozitat e cituara nga gjykata e shkallës së parë do të mund të gjenin zbatim vetëm nëse Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës do të ishte në fuqi në momentin e plotësimit të kushtit për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe në momentin e pensionimit, mirëpo meqenëse e njëjta në kohën e të dy kërkesave nuk ka qenë në fuqi, pala e paditur nuk i detyrohet palës paditëse në asnjë pagesë apo borxh siç i referohet gjykata e shkallës së parë. Për këto arsye, Gjykata e Apelit vendosi që aktgjykimi i atakuar duhet të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit duhet të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata e Apelit, vendimin për shpenzimet e procedurës, që secila palë t’i bartë shpenzimet e saj të procedurës, e ka bazuar në kuptim të nenit 450 të LPK-së, duke qenë së kërkesëpadia e paditësit është refuzuar si e pabazuar, ndërsa e paditura nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore.

Nga të cekurat më lartë, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e në bazë të nenit 195.1 pika e) e lidhur me nenin 201 par.1 pika d) të LPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7185/2022, datë 26.09.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari
Hysni Bardheci